



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 1097/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha edhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Izet Abdyli kryetar i degës së subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Drenas, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Prishtinë, për shkak të parregullsive në ndarjen e ulëseve për kandidat për anëtarë të asamblesë komunale, Drenas në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Izet Abdyli kryetar i degës së subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Drenas.

**Arsyetim**

PZAP-i, më datë 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Izet Abdyli kryetar i degës së subjektit politik LDK, dega në Drenas në të cilën theksohet se është bërë përlllogaritja jo e drejtë e ulëseve për këshilltar komunal si LDK me 1010 vota kemi një ulëse njëjtë si Partia e Drejtësisë me 370 vota, ndërsa Iniciativa Qytetare për Drenasin me 3236 vota ka 5 ulëse, po ashtu gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor në KQZ, KKZ Gillogovc ka patur mungesë 13 formular.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të subjektit politik LDK nuk qëndrojnë, sepse shpërndarja e vendeve nëpër kuvende komunale bëhet në bazë të nenit 8.1 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, me formulën të cilën e zbaton Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shpërndarjen e votave nëpër asamble, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.1097/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**



***Këshillë Juridike:***

Ndaj ketij vendimi mund të paraqitni ankese në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes se vendimit nga PZAP-i.